



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Kryetarja e Komunës

01nr _____

Dt: 17.12.2015

Kryetarja e Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 13 dhe 58 shkronja a dhe b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L-040 dhe Përfundimit 01 nr.06-84333 i dt: 26.11.2015, i miratuar nga Bordi i Drejtorëve sipas kërkesës së shpërndarë në mënyrë elektronike, me të cilin është aprovuar kërkesa e Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik për formimin e grupit punues për funksionalizimin dhe mbikëqyrjen e Njesisë për Menaxhimin e “Çarshisë së Madhe” në Gjakovë, me dt: 17.12.2015 e miraton këtë:

V E N D I M

1. Caktohet Grupi punues i Komunës së Gjakovës i cili do të punon në kuadër të Njesisë Menaxhuese të “Çarshisë së Madhe” në Gjakovë, e cila është themeluar sipas vendimit të Kuvendit të Komunës së Gjakovës 01 nr. 011-49971 i dt: 21.07.2015 , në këtë përbërje:

1. Lekë Sina , kryesues i grupit punues
2. Agron Gojani, anëtar
3. Lulzim Jupa , anëtar
4. Burbuqe Deva Bakija, anëtare
5. Ali Haraqija, anëtar
6. Visar Koshi, anëtar
7. Sahit Mula, anëtar

2. Anëtarët e Grupit punues të përshkruar në pikën paraprake duhet të angazhohen për kryerjen e detyrave dhe përgjegjësi vijuese:

- Fasilitimin e revitalizimit ekonomik dhe zhvillimit të qëndrueshëm në “Çarshinë e Madhe”.
- Hartimin dhe realizimin e planit vjetor të punës lidhur me organizimin dhe koordinimin në “Çarshinë e Madhe” .
- Bashkëpunimi me të gjitha palët e interesit, duke e përfshirë komunitetin në “Çarshinë e Madhe”, institucionet lokale dhe qendrore dhe grupet tjera të interesit.
- Aktivitetet tjera të ndryshme që ndërlidhen me funksionalizimin efikas të të gjitha komponentëve të “Çarshisë së Madhe”.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

4. Vendimi iu dorëzohet:

- Anëtarëve të Grupit punues
- Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik
- Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit
- Arkivit

Kryetarja e Komunës

Znj. Mimoza Kusari-Lila

